



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-4019/25
Kaçanik, 27.02.2025

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 24 dhe nenit 25 të Ligjit Nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të neni 15.3 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshim plotësimit të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, në pajtim me Vendimin për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/02-30044/2023, të datës 30.11.2023, të Raportit të Vlerësimit nga Divizioni për vlerësimin e pronave të paluajtshme për shpronësim dhe këmbim nr. njësisë 021/463, nr. protokollit 472-2/2025, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 27 shkurt 2025, mori këtë:

VENDIM

PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, ME PRONËN E PALUAJTSHME TË PERSONIT FIZIK, KUMRIJE (Bajram) TALI

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi 01Nr. 104/02-4019/25 i Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi private të personit fizik, Kumrije (Bajram) Tali.
2. Këmbimi i pronës së paluajtshme i cekur si në pikën 1. të këtij Vendimi, ka të bëjë me:
 - 2.1 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917048-01271-0, me sipërfaqe prej $S= 13 m^2$ nga sipërfaqja e përgjithëshme prej $S=430 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut me vendndodhje në Rr. "Esat Axhami", Kaçanik, ZK Kaçanik, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithshme prej 195.00 €,
 - 2.2 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917048-01272-1, me sipërfaqe prej $S= 278 m^2$ nga sipërfaqja e përgjithëshme prej $S=11390 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut me vendndodhje në Rr. "Esat Axhami", Kaçanik, ZK Kaçanik, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithshme prej 4,170.00 €,
 - 2.3 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917048-01274-1, me sipërfaqe prej $S= 164 m^2$ nga sipërfaqja e përgjithëshme prej $S=1113 m^2$, në pronësi Komuna e Kaçanikut me vendndodhje në Rr. "Avdurrahim Shehu", Kaçanik, ZK Kaçanik, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithshme prej 2,460.00 €, të cilat këmbëhet me:
 - 2.4 Pjesa e parcelës Kadastrale P-70917048-01965-2, me sipërfaqe prej $S= 455 m^2$ nga sipërfaqe të përgjithshme prej $S= 3544 m^2$, në pronësi të personit fizik, Kumrije (Bajram) Tali, me vendbanim në Rr."Selim Shehu", Kaçanik, ZK Kaçanik, e vlerësuar sipas raportit me shumën e përgjithshme prej 6,825.00 €.

3. Këmbimi i pronës së paluajtshme bëhet me qëllim që të krijohet mundësi për zgjerimin e hapësirës publike.
4. Kompromisi i pronës të personit fizik që është objekt i këmbimit, do të bëhet me pronën komunale, të cilat janë vlerësuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, në Ministrinë e Financave.
5. Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.
6. Zbatimin e këtij vendimi do të bëjë Drejtoria për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, gjegjësisht Zyra Komunale Kadastrale -Kaçanik, e cila do të bëjë regjistrimin e pronave dhe të drejtën e pronësisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
8. Pjesë përbërëse të këtij Vendimi janë: Vendimin për shpallje në interes publik me nr. të protokollit 01nr.104/01-6738/2024, të datës 29.03.2024; Raporti i Vlerësimit nga Divizioni për vlerësimin e pronave të paluajtshme për shpronësim dhe këmbim nr. njësisë 021/463, nr. protokollit 474-2/2025; Certifikatën e pronësisë dhe kopjen e planit të pronave që janë objekt i këmbimit dhe Skica.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria për Buxhet dhe Financa; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

